



Projekti: “Ndjekja dhe verifikimi i premtimeve të fushatës zgjedhore në Shqipëri”

Projekti ndihmon qytetarët shqiptarë që të gjejnë dhe regjistrojnë premtimet elektorale të politikanëve shqiptarë. Projekti ofron mjete dhe mundësi për të verifikuar realizimin e këtyre premtimeve.

Qëllimi është që të mbahen nën përgjegjësi lidhur me premtimet deputetët e parlamentit shqiptar dhe të zgjedhurit lokalë, kryetarët e Bashkive.

Këtij qëllimi i shërben përgatitja e buxheteve qytetare, që janë versione të thjeshtuara të buxheteve bashkiake për vitin 2020. Nëpërmjet këtyre buxheteve qytetarët do të kuptojnë më mirë mënyrën e shpenzimeve dhe se si shpenzohen taksat e tyre.

Ju lutemi të gjeni në këtë dokument buxhetin e thjeshtuar qytetar të Bashkisë Cërrrik.

Ju falenderojmë për mbështetjen dhe bashkëpunimin!

Buxheti Qytetar i Bashkisë Cërrik, Viti 2020:

1. Analiza e parashikimit të të ardhurave për vitin fiskal 2020

Studimi ka për qëllim të analizojë parashikimin për të ardhurat e vitit 2020, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.


Bazuar në Ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifatat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë.

Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve, /000 lek

Burimet e financimit	Viti 2019	Viti 2020	Diferenca 2020-2019
Transferta e pakushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të lirë)	137,466 (36%)	140,804 (39%)	3,338
Transferta e kushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	25,548 (5%)	4651 (1%)	-20,897
Transferta specifike (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	83,228 (17%)	84,722 (23%)	1,494
Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë)	78,264 (16%)	86418 (23.7%)	8,154
Të ardhura të tjera (të ardhura nga institucionet që Bashkia ka nën varësinë e saj)	56,209 (11%)	48,556 (13.3%)	-7,653
Total	380,175	365,151	-15,564


Burimi: Bashkia Cërrik, 2020, llogaritje EIC

Figura 1. Të ardhurat totale, Bashkia Cërrik 2019




Burimi: Bashkia Cërrik, 2020, Ilogaritje EIC

Figura 2. Të ardhurat totale, Bashkia Cërrik 2020



Burimi: Bashkia Cërrik, 2020, Ilogaritje EIC

Figura 3. Të ardhurat totale, Bashkia Cërrik



Burimi: Bashkia Cërrik, 2020, llogaritje EIC

Më poshtë është dhënë parashikimi mbi të ardhurat nga taksat dhe tarifatat, duke zbritur të ardhurat nga gjobat, insitucionet e varësisë dhe shërbimet e ofruara nga Bashkia.

Tabela 2. Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat në /000 Lekë

Njësia vendore	Të ardhurat nga taksat & tarifatat 2020
Bashkia Cërrik	86,419 (të ardhurat pa gjobat & të ardhurat e tjera vendore)
	Të ardhurat vendore
	134,975

Burimi: Bashkia Cërrik, 2020, llogaritje EIC

Tabela 3. Lista e taksave vendore (detyrime që paguajnë qytetarët për shërbimet e marra nga Bashkia)

(Bilanci 2019 është i pritshëm, pasi sipas Ligjit mbi dorëzimet e bilanceve, bilanci i mbyllur i vitit 2019 dorëzohet deri më 31 Mars 2020. Më pas del vlera reale).

Nr.	Lloji i taksës	Plani i pritshëm në 000 Lekë 2019	Plani 2020	Diferenca në/000 Lekë 2020 -2019	Diferenca në % Lekë 2020 -2019	% mbi totalin e të ardhurave vendore 2020
1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	905	905	-	0 %	0.7 %
2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	32,400	32,951	551	2 %	24.4 %
3	Taksa vendore në shërbimin hotelier	13	13	-	0 %	0 %
4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	6,000	7,500	1,500	25 %	5.6 %
5	Taksa e tabelës	640	1,050	410	64 %	0.8 %
6	Taksa të përkohshme	150	150	-	0 %	0.1 %
7	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	10,366	11,000	634	6 %	8.1 %
8	Taksa e rentës minerare	30	30	-	0 %	0 %
9	Të tjera	10	10	-	0 %	0 %
TOTALI		50,514	53,609	3,095	6 %	39.7 %

Burimi: Bashkia Cërrik, 2020, llogaritje EIC

Tabela 4. Lista e tarifave vendore (detyrime fikse që paguajnë qytetarët për shërbimet e marra nga Bashkia)

Nr.	Lloji i tarifës	Plani i pritshëm në /000 Lekë 2019	Plani 2020	Diferenca në /000 Lekë 2020 -2019	Diferenca në % Lekë 2020 -2019	% mbi totalin e të ardhurave vendore 2020
1	Tarifa për menaxhimin e mbetjeve	15,000	15,400	400	3 %	11.4 %
2	Tarifa për ndriçimin publik	1,800	2,000	200	11 %	1.5 %
3	Tarifa për gjelbërimin	1,200	1,320	120	10 %	1 %
4	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	8,330	12,500	4,170	-	9.3 %
5	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	1,100	1,200	100	9 %	0.9 %
6	Tarifa e përkohëshme	270	340	70	-	0.3 %
7	Tarifa të tjera	50	50	-	-	0 %
TOTALI		27,750	32,810	5,060	18.2 %	24.3 %


Burimi: Bashkia Cërrik, 2020, llogaritje EIC

Tabela 5. Lista e të ardhurave të tjera vendore (shërbimet që ofron Bashkia/gjoha dhe institucionet vartëse)

Nr.	Lloji i taksës	Plani i pritshëm në /000 Lekë 2019	Plani 2020	Diferenca në /000 Lekë 2020 -2019	Diferenca në % Lekë 2020 -2019	% mbi totalin e të ardhurave vendore 2020
1	Qeraja nga asetet në pronësi	8,300	8,320	20	0	6.2 %
2	Kundravajtjet administrative (gjobat)	695	600	- 95	-14 %	0.4 %
3	Të tjera	47,214	39,636	- 7,578	- 16 %	29.4 %
TOTALI		56,209	48,556	- 7,653	-13.6	36.0%


Burimi: Bashkia Cërrik, 2020, llogaritje EIC

Figura 4. Të ardhurat vendore në vlerë 2019 – 2020




Burimi: Bashkia Cërrik, 2020, llogaritje EIC

Figura 5. Të ardhurat vendore në % ndaj totalit të të ardhurave



Burimi: Bashkia Cërrik, 2020, llogaritje EIC

Figura 6. Diferenca e të ardhurave në %



Burimi: Bashkia Cërrik, 2020, llogaritje EIC

**Tabela 6. Transfertat qeveritare në/000 Lekë
(fonde të deleguara nga Qeveria për Bashkitë)**

Emërtimi	2020	% mbi Tot. Ardh.
Transferta e pakushtëzuar	140,804	(39%)
Transferta e kushtëzuar	4,651	(1%)
Transferta specifike	84,722	(23%)

Burimi: Bashkia Cërrik, 2020, llogaritje EIC

2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Cërrik për vitin fiskal 2020

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fondeve, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përse shpenzohen nga bashkia?

Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2020. Më poshtë po japim tabelën përmbljedhëse të shpenzimeve:


Tabela 7. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale

Emërtimi i shpenzimit	Viti 2019 në /000 Lekë	Viti 2020 në /000 Lekë	Diferenca në vlerë në /000 Lekë	Diferenca në %	% mbi totalin e të ardhurave
Shpenzime Paga+Sig.Shoqërore	200,855	196,737	- 4,118	- 2.1	53.9
Shpenzime Korrente	83,512	91,410	7,898	9.5	25
Shpenzime Kapitale	121,182	107,213	- 13,969	- 11.5	29.4
TOTALI	405,549	395,360	- 10,189	- 2.5	108.3

Burimi: Bashkia Cërrik, 2020, Ilogaritje EIC


Referuar figurës 7, vërehet se nga krahasimi i dy viteve të njëpasnjëshëm (2019-2020), zërat e shpenzimeve që kanë të bëjnë me pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shpenzimet kapitale, kanë pësuar ulje në vitin 2020.

Figura 7. Diferenca e shpenzimeve për vitin 2019-2020



Burimi: Bashkia Cërrik, 2020, Ilogaritje EIC

Figura 8. Shpenzimet totale si raport mbi të ardhurat totale



Burimi: Bashkia Cërrik, 2020, llogaritje EIC

Në tabelën e mëposhtme janë evidentuar shpenzimet e Bashkisë Cërrik sipas programeve dhe si % ndaj totalit të të ardhurave.

Tabela 8. Shpenzimet sipas programeve dhe si % ndaj Tot.të ardh.vendore

Emërtimi i shpenzimit	Shpenzime Totale në 000 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
Programi ekzekutiv & legjislativ, çështje financiare	79,280	21.7
Shërbime të huamarrjes vendore	-	-
Shërbime policore	4,980	1.4
Shërbimet e mbrojtjes ndaj zjarrit	18,500	5.1
Marrëdhëniet me komunitetin	-	-
Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregëtare	-	-
Bujqësia & pyjet, peshkimi, gjuetia	51,000	14
Transporti	56,000	15.3

Industri të tjera	-	-
Menaxhimi i mbetjeve	18,000	4.9
Menaxhimi i ujërave të zeza	-	-
Reduktimi i ndotjes	-	-
Mbrojtja e mjedisit	-	-
Urbanistika	10,000	2.7
Zhvillimi i komunitetit	30,600	8.4
Furnizimi me ujë	-	-
Ndriçimi i rrugëve	12,800	3.5
Shërbimet e kujdesit parësor	-	-
Shërbimet rekreative & sportive	13,600	3.7
Shërbimet kulturore	11,300	3.1
Arsimi bazë & parashkollor	70,000	19.2
Arsimi parauniversitar	12,800	3.5
Sëmundje & paaftësi	1,000	0.3
Të moshuarit	-	-
Familje & fëmijë	5,500	1.5
Papunësia	-	-
Strehimi social	-	-
TOTALI	395,360	108.3

Burimi: Bashkia Cërrik, 2020, llogaritje EIC